

**LIGJ**  
**Nr.10 139, datë 15.5.2009**  
*(Ndryshuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

*(I përditësuar)*

**PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË  
UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE  
ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA  
INSTITUCIONEVE TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË, TË CILËT KANË TITUJ SHKENCORË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është që personave të grupit të parë dhe të dytë, sipas përcaktimit në nenin 2 të këtij ligji, t'u jepen pensione suplementare shtetërore, si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2  
**Përkufizime**

*(Shtuar fjalë në shkronjën “a” të pikës 3, shtuar shkronja “c” dhe ndryshuar pika 4, me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime;

1. “Pensione suplementare” janë përfitimet që jepen sipas këtij ligji.
2. “Kontribut suplementar” është kontributi që paguhet sipas këtij ligji.
3. “Periudhë e ushtrimit të titullit” është:

a) Periudha deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, gjatë së cilës personat kanë gëzuar titullin shkencor “Profesor”, “Profesor i asociuar” (“Drejtnes kërkimesh”, “Mjeshtër kërkimesh”), sipas vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe personat me tituj shkencorë “Profesor”, “Docent”, “Bashkëpunëtor i vjetër shkencor”, të cilët i kanë pasur këto tituj para vitit 1994 dhe i kanë përfituar pasi është fituar më parë grada shkencore “Kandidat i shkencave”.

b) Periudha pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjatë së cilës personat kanë gëzuar titullin shkencor “Profesor”, “Drejtnes kërkimesh”, “Profesor i asociuar”, “Mjeshtër kërkimesh”, sipas vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe kanë derdhur kontribut suplementar, duke qenë në marrëdhënie pune me universitetet,

shkollat e larta, Qendrën e Studimeve Albanologjike, Akademinë e Shkencave dhe me të gjitha institucionet e tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë.

c) institucionet jopublike, ku punësimi i personave me tituj vlerësohet si periudhë e ushtrimit të titullit, për efekt të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. “Pagë referuese” është paga bazë për titullin në institucionet publike, përjashtuar shtesat për funksion. Për efekt të përcaktimit të përfitimeve, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të ushtrimit të titullit.

5. “Grupi i parë” janë profesorët dhe drejtues kërkimesh, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3 të këtij neni.

6. “Grupi i dytë” janë “Profesorë të asociuar” dhe “Mjeshtër kërkimesh”, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3 të këtij neni.

### Neni 3 **Financimi**

Përfitimet shtetërore suplementare, që jepen sipas këtij ligji, financohen nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) kontributi suplementar.

### Neni 4 **Masa e kontributeve**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

Masa e kontributit suplementar që paguhet nga të punësuarit e përfshirë në këtë skemë suplementare është:

- a) 5 për qind e pagës referuese të titullit për të punësuarit në sektorin publik;
- b) 7 për qind e pagës referuese të titullit për të punësuarit në sektorin jopublik.

### Neni 5 **Pagesa e kontributeve**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

Pagesa e kontributeve suplementare bëhet në organet e tatim-taksave dhe ndjek të njëjtat procedura e afate, si për mbledhjen e kontributeve nga skema e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.

## KREU II PENSIONE SUPLEMENTARE PLEQËRIE

### Neni 6 **Kushti i përfitimit**

Kushti për të përfituar pension suplementar shtetëror, sipas këtij ligji, është që personat, të cilët përfshihen në grupin e parë dhe të dytë të pikave 5 dhe 6 të nenit 2, të plotësojnë kriteret për marrjen e pensionit të pleqërisë, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

### Neni 7 **Masa e pensionit** *(Ndryshuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

1. Masa mujore e pensionit suplementar është 1,3 për qind e pagës referuese për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit “Profesor” / “Drejtues kërkimesh” dhe 1,1 për qind e pagës referuese për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit “Asistent profesor”/ “Mjeshtër kërkimesh”.

Masa e pensionit suplementar për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit “Docent” dhe të titullit “Bashkëpunëtor i vjetër shkencor” është 1,1 për qind e pagës referuese. Paga referuese përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Shuma mujore e pensionit suplementar, bashkë me përfitimet nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit të pleqërisë, të përfituar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Masa mujore e pensionit suplementar nuk mund të jetë në asnjë rast më e vogël se 6 për qind e pagës referuese.

4. Masa mujore e pensionit suplementar fillestar për personat që nuk kanë kontribuar nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë, të përfituar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 8

### **Indeksi**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

Pensionet shtetërore suplementare indeksohen. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **KREU III**

### **DISPOZITA TË PËRBASHKËTA**

Neni 9

Kur periudha e ushtrimit të titullit nuk është e plotë në vite, për efekt llogaritjeje të masës së përfitimit, koeficienti në përqindje mbi pagën referuese, sipas nenit 7 të këtij ligji, llogaritet për çdo muaj.

Neni 10

### **E drejta për përfitim**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

1. E drejta për pension suplementar nuk parashkruhet.
2. Personit, që kërkon pensionin suplementar, brenda 1 viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky pension që nga ajo datë. Në raste të tjera, pensioni paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.
3. Përfitimet e njohura nga ky ligj, por të patërhequra, do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se tre vjet.
4. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet.
5. E drejta e organit kompetent për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se tre vjet nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se gjashtë muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të përfitimit.

Neni 10/1

### **Të drejtat e fituara**

*(Shtuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015)*

Pensionet shtetërore suplementare me datë fillimi deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfshi edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rillogaritjeje, përveç indeksimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 11

Pensionet suplementare për titujt shkencorë administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kundrejt një komisioni, që paguhet nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 12

Përfitimet suplementare për titujt shkencorë jepen me kërkesën e të interesuarit, i cili paraqet dokumentacionin përkatës. Kërkesa për përfitim paraqitet pranë agjencive vendore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Dokumentet, që i bashkëlidhen kërkesës dhe forma e tyre përcaktohen me akte nënligjore.

#### Neni 13

Llogaritja, caktimi dhe pagesa e përfitimeve suplementare bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Buxheti i Shtetit cakton çdo vit fondet e nevojshme pranë buxhetit të institutit. Procedurat e zbatimit të buxhetit për këtë qëllim ndjekin të njëjtat rregulla dhe afate si ato të Buxhetit të Shtetit.

### KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 14

#### **Përfitimi nga ligje të ndryshme** (*Ndryshuar me ligjin nr. 108/2015, datë 15.10.2015*)

Pensionimi suplementar, sipas këtij ligji, përfitohet edhe në rastet kur personi përfiton pension të posaçëm shtetëror, pension nga një skemë tjetër suplementare ose trajtim të veçantë, me kusht që periudhat e shërbimit të mos mbivendosen.

#### Neni 15

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore të parashikuara nga nenet 4 e 11 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij ligji.

#### Neni 16

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2010.

**Shpallur me dekretin nr.6197, datë 5.6.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

